

## THIRRJE PËR OFERTIM

### Për realizimin e një dokumentari në kuadër të projektit “Filigrani përtej artizanatit”

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren është duke zbatuar projektin “Filigrani përtej Artizanatit”, financuar nga projekti “Dialogu ndërmjet komuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë Kulturore”, që implementohet nga UNDP dhe financohet nga Instrumenti i Bashkimit Evropian që kontribuon për Stabilitet dhe Paqe (IcSP). Qëllimi i këtij projekti është që të kontribuoj në ruajtjen e artizanatit të filigranit përmes dokumentimit, promovimit dhe transferimit të njohurive dhe shkathtësive të kësaj zeje tek gratë dhe të rinjtë, me qëllim të rritjes së mundësisë së punësimit.

Në kuadër të këtij projekti do të realizohet një dokumentar – video material për artizanatin e filigranit. Videoja e prodhuar do të dokumentojë artizanatin e filigranit, duke dhënë detaje relevante mbi filigranin. Pamjet do të shoqërohen nga një transmetim profesional, ndërsa dokumentari do të shpërndahet përmes kanaleve të mediave sociale. Videoja do të jetë pjesë e dokumentimit zyrtar dhe procesit të inventarizimit të artizanatit të filigranit, që bën pjesë në asetet e trashëgimisë kulturore jomateriale. EC Ma Ndryshe do të përzgjedh një kompani të specializuar për prodhimin e videos dhe realizimin e procesit të dokumentimit

#### *Kushtet dhe detyrat e paracaktuara për kompaninë ofertuese:*

- Do të bëjë video-dokumentimin e procesit të filigranit sipas udhëzimeve dhe kërkesave të stafit menaxhues të projektit “Filigrani përtej artizanatit”
- Do të realizojë intervista me filigranistë të qytetit të Prizrenit, pjesëmarrës të punëtorive në kuadër të projektit dhe individë të tjerë të përcaktuar nga stafi menaxhues i projektit
- Do të draftoj konceptin artistik dhe realizues të dokumentarit, duke specifikuar ecurinë e punës dhe etapat e nevojshme për realizimin e xhirimeve
- Do të jetë në dispozicion për të përcjellur aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit “Filigrani përtej Artizanatit”, për të cilat do të informohet paraprakisht nga stafi menaxhues i projektit
- Do të angazhohet dhe finalizojë montazhen, titrimin dhe përkthimin e dokumentarit

#### *Kriteret e përzgjedhjes:*

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret e përzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm,
- Stafi permanent dhe bashkëpunëtorët e jashtëm
- Fleksibilitet gjatë gjirimeve dhe realizimit

#### *Të tjera:*

- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme/në dispozicion për xhirime kur kërkohet nga punëdhënësi (gjatë muajit Maj - Qershor 2019)
- Të gjitha xhirimet do të bëhen në Prizren
- Kohëzgjatja e dokumentarit të prodhuar do të jetë rreth 15 minuta televizive
- Përkthimi dhe titrimi i dokumentarit do të bëhet në gjuhën angleze

*Aplikimi:*

Ju lutem dërgoni ofertën tuaj financiare në zyrat e organizatës **Rruga "Fehmi Lladrovci" 94, 20000 Prizren** apo në email adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) dhe shkruani në subject "Ofertë për realizimin e dokumentarit për zejen e filigranit", më së largu deri më **26 Prill 2019**, në orën **16:00**. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. Bashkë me ofertën tuaj financiare, ju lutem bashkëngjitni edhe këto dokumente: certifikata e regjistrimit të biznesit, certifikata e numrit fiskal, certifikata e TVSh-së (kompanite që janë deklaruese të TVSH-së).

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrjes për aplikim, ju lutemi vizitoni [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).